



OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU SH.A.
TRANSMISSION, SYSTEM AND MARKET OPERATOR J.S.C.
OPERATOR SISTEMA, PRENOSA I TRZISTA, A.D.

BULETINI 10

Buletini nr.10 • Viti VIII, 2015



PËRMBAJTJA

Në Nënstacionin 400/110 kV Ferizaj 2 vëhet gurthemeli për autotransformatorin e dytë me kapacitet transformues prej 300 MVA	3
Historiku, Zhvillimet dhe sfidat e KOSTT-it për anëtarësim në ENTSO/E	5
Ministrja për Dialog znj.Edita Tahiri vizitoi KOSTT-in	7
Ministrat Stavileci dhe Gjijnuri vlerësojnë progresin e punimeve në linjën interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri	8
BERZH akordon kredinë e parë për KOSTT me qëllim të zhvillimit të Sistemit Transmetues të energjisë elektrike të Republikës së Kosovës	9
Procesi i Shkëmbimit Ndërkufitar i të Dhënave Komerciale (Skedulimit) të KOSTT pas Nënshkrimit të Marrëveshjes për Kyçe me ENTSO-E	10
KOSTT përkrah Baletin Kombëtar të Kosovës	11
Vendimet e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë Janar– Qershor 2015	12

Buletini nr.10, Viti VIII, 2015

Buletini është publikim i KOSTT sh.a,

Rr. Iljaz Kodra p.n, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +381(0) 38 501 301 174 ; email: info@kostt.com

Web: www.kostt.com

Për më shumë informata rreth Buletinit, ju lutem kontaktoni:

Zyrën për Komunikim dhe Relacione me Publikun në:

zana.rama@kostt.com ose info@kostt.com

Në Nënstacionin 400/110 kV Ferizaj 2 vëhet gurthemeli për autotransformatorin e dytë me kapacitet transformues prej 300 MVA



Naim Bejtullahu, KOSTT

Në një ceremoni solemne në Nënstacionin 400/110 kV Ferizaj 2, Ministri për Zhvillim Ekonomik i Republikës së Kosovës z.Blerand Stavileci, Ambasadorja e RF të Gjermanisë znj. Angelika Viets, zv.drejtori për bashkëpunim nga Zyra e BE në Kosovë z.Libor Chlad, Drejtori për EJL dhe Turqi në KfW z.Christoph Tiskens dhe Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Naim Bejtullahu, vunë gurthemelin me rastin e nisjes së implementimit të projekteve në kuadër të “Programit IV dhe V” për zhvillimin e infrastrukturës së transmetimit të energjisë elektrike në Kosovë.

Më konkretisht, në Nënstacionin Ferizaj 2 do të instalohet Autotransformatori i dytë ATR2, me kapacitet transformues prej 300 MVA (megavolt amper) si dhe instalimi i pajisjeve të tensionit të lartë për fushat transformatorike 400 kV dhe 110 kV.

Zbatimi i këtij projekti do të ndikoj në:

- plotësimin e kriterit të sigurisë N-1 i cili përbën një nga parakushtet kryesore teknike për anëtarësim në ENTSO-E (Rrjeti i OST-ve Evropiane për energji elektrike/European Network Transmission System Operators-Electricity).

- ngritjen e kapacitetit të përgjithshëm transformues të rrjetit transmetues të Republikës së Kosovës për 300 MVA
- rritjen e rrjedhave të fuqisë nga niveli 400 kV në atë 110 kV në NS Ferizaj 2, duke shkarkuar ndjeshëm ngarkesën në auto-transformatorët e NS Kosova A dhe NS Prishtina 4
- ngritja e sigurisë dhe besueshmërisë së furnizimit me energji elektrike nga aspekti i transmisionit

Ky projekt është pjesë e Projektit “Përmirësimi i Rrjetit të Transmisionit, Programi IV dhe V i Sektorit” i cili parashih implementimin e 10 projekteve që mundësohen përmes kredisë komerciale afatgjate që KOSTT sh.a e ka siguruar nga Banka Gjermane për Zhvillim (KfW) me kushte kredituese të buta në vlerë prej € 23,5 milion nga e cila € 15,5 milion me periudhë kthyesë prej 15 viteve dhe €8 milion me periudhë kthyesë prej 40 viteve, si dhe financimin shtesë në formë granti nga Komisioni Evropian në vlerë prej € 7.35 milion përmes programit IPA.

Implementimi i projekteve në fjalë, që njëherit janë pjesë e Planit Zhvillimor të Transmisionit 2015-2024, do të kenë ndikim të theksuar në sigurinë, besueshmërinë dhe cilësinë e furnizimit me energji elektrike nga aspekti i transmisionit, rritjen e kapaciteteve transmetuese dhe transformuese të energjisë elektrike, plotësimin e kriterit N-1 dhe ngritjen e performancës operuese të Sistemit të Transmisionit të Republikës së Kosovës. Me këtë rast, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Naim



Vënia e gurtbemelit me rastin e nisjes së implementimit të projekteve në kuadër të “Programit IV dhe V”

Bejtullahu theksoi “Operimi i sigurt dhe i besueshëm i Sistemit Transmetues, është qenësor për funksionimin e tërësishëm të Sistemit Elektroenergetik të Republikës së Kosovës, prandaj u jam mirënjohës Bashkimit Evropian dhe Qeverisë Gjermane e në veçanti KfW-së për mbështetjen financiare për zhvillimin dhe modernizimin e Sistemit Transmetues. KOSTT deri më tani ka siguruar tri kredi komerciale afatgjate me qëllim të financimit të projekteve kapitale, dy nga KfW dhe një nga BERZH. Qëllimi ynë është zhvillimi dhe modernizimi i Sistemit Transmetues konform standardeve dhe kriterëve teknike të ENTSO-E (Organizata Europiane e Operatorëve të Sistemeve të Transmetimit), e për më tepër krijimin e parakushteve për zhvillimin ekonomik dhe industrial të vendit. Ju falemnderit për besimin”.

Ndërsa Ministri i Zhvillimit Ekonomik z.Blerand Stavileci theksoi “Qeveria do të mbështes gjithmonë investimet kapitale që e përmirësojnë infrastrukturën energjetike, që është edhe prioritet i saj, në kuadër të prioritetëve në këtë sektor, siç janë ndërtimi i

kapacitetet e reja energjetike ashtu siç janë të parapara në Strategjinë e Energjisë”.



Nënshkrimi i kontratave për projektin “Përmirësimi i Rrjetit të Transmisionit, Programi IV dhe V I Sektorit”

“Ambasadorja e Gjermanisë në Prishtinë, Angelika Viets tha me këtë rast se vendi i saj që nga viti 1999 përmes KfW ka investuar 155 milionë euro në sektorin e energjisë, duke shtuar se ky sektor duhet të vazhdojë të jetë prioritet i Qeverisë së Kosovës në mënyrë që të ketë investime, ndërsa Gjermania do të vazhdojë mbështetjen e saj.”

Nënstacioni 400/110 kV Ferizaj 2, është një nga nënstationet më të rëndësishme të Sistemit Elektroenergetik të Kosovës, në të cilin lidhet linja interkonektive 400 kV Kosovë-Maqedoni. Nënstacioni Ferizaj 2 është ndërtuar në vitin 2011 me bashkëfinancim nga Qeveria e Kosovës dhe fondet e Bashkimit Evropian.

Nënshkrimi i Marrëveshjes për Kredi me KfW është bërë me datë 23 Shtator 2013, ndërsa me 19 Mars 2015 janë nënshkruar kontratat për implementim të projekteve.

Projekti “Përmirësimi i Rrjetit të Transmisionit, Programi IV dhe V i Sektorit”, përbëhet nga tri LOT-e

LOT 1: Nënstationet - i cili do të implementohet nga kompania austriake SIEMENS.

Lot 2: Transformatorët – i cili do të implementohet nga kompania kroate Konçar Power Transformers.

Lot 3: Linjat e Transmisionit – i cili do të implementohet nga kompania kroate Dalekovod (Zagreb).

Nga momenti i fillimit të punimeve, implementimi i projekteve parashihet që të përfundojë në afat prej 24 muajsh.

Historiku, Zhvillimet dhe sfidat e KOSTT-it për anëtarësim në ENTSO/E

Fillimisht historiku i rrjetit të transmisionit të Kosovës, në relacion me ENTSO/E, që më parë quhej UCPTE, fillon në vitin 1980 me themelimin e Operatorit të pavarur të transmisionit të Kosovës të quajtur “ELEKTROBARTJA PRISHTINË” e cila ishte në kuadër të kompanisë vertikalisht të integruar KEK. Operatori i Sistemit të Transmisionit të Kosovës ishte pjesë e barabartë në mesin e tetë operatorëve të ish-Jugosllavisë që përbënin JUGEL-in e themeluar në vitin 1981. Operatori i Kosovës në atë kohë kishte të gjitha përgjegjësitë, obligimet dhe beneficimet si të gjithë operatorët tjerë, duke operuar sistemin elektroenergetik të Kosovës nga qendra e atëhershme dispeçerike sipas kërkesave të asaj kohe të UCPTE-së (UCTE). Periudha kohore 1990-1999 pas suprimimit të autonomisë së Kosovës deri në vitin 1999 kur përfundon lufta në Kosovë, paraqet periudhën e errët edhe për operatorin e sistemit të transmisionit, e shkaktuar nga regjimi i atëhershëm serb. Në mënyrë të dhunshme largohen nga puna stafi dhe suprimohet statusi i operatorit të pavarur të sistemit të transmisionit të Kosovës, e cila tërësisht futet në menaxhim të dhunshëm nga kompania e atëhershme serbe ZEP e cila ishte në kuadër të JUGEL-it.

Pas përfundimit të luftës në Kosovë nga viti 2000 deri në 2006, sistemi i transmisionit dhe dispeçingut operon në kuadër të kompanisë vertikalisht të integruar KEK (Korporata Elektroenergetike e Kosovës). Në vitin 2006 fillon procesi i shthurjes së kompanisë vertikalisht të integruar KEK me ç' rast themelohet Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut –KOSTT me pronarë Republikën e Kosovës, përmes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik. Nga këndvështrimi i operimit të sistemit në relacion me sistemet fqinje dhe me UCTE-n edhe pas kësaj periudhe sistemi i transmisionit të Kosovës nuk njihet nga UCTE-ja dhe palët tjera jashtë vendit, ajo konsiderohet si një sistem i integruar në kuadër të zonës rregulluese të EMS (Elektro Mreza Serbije), respektivisht në kuadër të bllokut rregullues JIEL-SMM. Në vitin 2001 është bërë marrëveshja e përkohshme ndërmjet UNMIK-ut (në emër të Kosovës) dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik të Serbisë për

trajtimin e përdorimit të rrjetit të transmisionit për çështje tranziti dhe humbjeve, si dhe ofrimit të rregullimit sekondar të sistemit në brezin rregullues $\pm 20\text{MW}$. Në vitin 2004 pas krijimit të EMS dhe themelimit të fondit për kompenzim të humbjeve dhe tranzitit, EMS në mënyrë unilaterale vendosë që asetet e transmisionit të Kosovës ti vendos si asete të EMS duke privuar sistemin e transmisionit të Kosovës nga e drejta e kompenzimit për humbjet e shkaktuara nga tranziti i energjisë elektrike përmes rrjetit të transmisionit të Kosovës si dhe nga e drejta e kompensimit për infrastrukturë.

Që nga themelimi, KOSTT me përkushtim të lartë ka punuar me të gjitha kapacitetet e veta që statusi i



Gazmend Kabashi, Kadri Kadriu, Sabri Musiqi dhe Xhavit Sadiku

sistemit të transmisionit dhe në relacion me UCTE/ENTSO/E dhe sistemet fqinje të jetë i barabartë sikurse OST-të tjera të cilat operojnë në rrjetin e përbashkët Evropian. Ky përkushtim fiton një intensitet edhe më të lartë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008. Po në të njëjtin vit KOSTT dorëzon ankesë në Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore (SKE) për shkelje të Traktatit të Komunitetit të Energjisë për EJM nga ana e Serbisë (SKE nr.ECS-3/08). Në shtator të vitit 2010, SKE hapi procedurën e kontestit ndaj Serbisë për shkelje të dispozitave të Traktatit të Energjisë. Në tetor të vitit 2011 SKE ka dorëzuar "Reasoned Opinion/Mendim i bazuar" në të cilin konkludon se Republika e Serbisë, përmes EMS (OST e Serbisë) ka dështuar në implementimin/respektimin e Nenit 3 dhe 6 të Rregullores së

KE-së 1228/2003 për kushtet e qasjes në rrjet për shkëmbimet ndërkufitare të energjisë elektrike.

Marrëveshja për Energji Kosovë-Serbi dhe aktivitetet në relacion me ENTSO/E

Nënshkrimi i marrëveshjes për energji ndërmjet dy Kryeministrave Kosovë-Serbi dhe Baroneshës Eshton me 08.09.2013, dinamizon procesin e implementimit të relacioneve të barabarta të KOSTT-it me sistemet fqinje dhe me ENTSO/E. Me këtë marrëveshje definohet që brenda 3 muajve KOSTT duhet të nënshkruaj marrëveshjen e operimit me EMS, do të arrihen marrëveshjet për shfrytëzim të rrjetit dhe kompenzimin e humbjeve, si dhe për alokimin e kapaciteteve të interkoneksionit. EMS obligohet që do të mbështes KOSTT-in në anëtarësim në ENSTO-E, etj.

Marrëveshja Kornizë që rregullon marrëdhëniet e operimit dhe tregut midis KOSTT (Kosovë) dhe EMS (Serbi) është nënshkruar me 12.02.2014. Marrëveshja Kornizë është obligative për normalizimin e marrëdhënieve mes dy operatorëve të sistemit të energjisë elektrike. Marrëveshja kornizë parasheh:

- Rregullimet e mëtejshme do të bëhen për të siguruar që KOSTT të bëhet zonë rregulluese si pjesë në ENTSO-E,
- KOSTT merr pjesë në mekanizmin evropian të kompensimit ndërmjet operatorëve të sistemit të transmisionit (ITC)
- KOSTT në mënyrë efektive alokon kapacitetet në interkoneksionet me TSO fqinje
- Marrëveshja synon gjithashtu për të sjellë përfundimin e mosmarrëveshjeve ndërmjet KOSTT dhe EMS edhe për rastin e ankesës ndaj Serbisë në Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, i njohur si rasti ECS-3/08.

Negociatat rreth Marrëveshjes Kornizë janë ndihmuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë për EJKL së bashku me ekspertë nga Komisioni Evropian.

Në kuadër të aktiviteteve të implementimit të marrëveshjes Kosovë-Serbi, KOSTT krijon planin aksional të implementimit, duke krijuar grupet teknike punuese. Grupet punuese kanë punuar në përpilimin e marrëveshjeve ndër OST me EMS dhe me tri sistemet fqinje MEPSO, EPCG dhe OST. Marrëveshja Ndër-OST dhe anekset e tij teknike përfshijnë bazën ligjore dhe teknike për operim të pavarur të sistemeve elektroenergetike të vendeve përkatëse. Me datën 14.09.2014 KOSTT dhe EMS kanë nënshkruar Marrëveshjen Ndër-OST për menaxhimin e rrjetit dhe sistemit të operimit. Në marrëveshje është vendosur që KOSTT dhe EMS operojnë si dy zona të pavarura rregulluese konform

kërkesave që rrjedhin nga ENTSO-E. Në katërmujorin e parë të vitit 2015 nënshkruhen edhe marrëveshjet tjera ndër-OST me sistemet fqinje: MEPSO (Maqedoni), CGES (Mali i Zi) dhe OST (Shqipëri).

Paralel me aktivitetet e zhvilluara në KOSTT për marrëveshjet ndër-TSO, gjatë fund vitit 2014 dhe gjatë vitit 2015 janë zhvilluar edhe aktivitetet tjera që ndërlidhën me relacionet KOSTT-ENTSO/E. Takimi me ENTSO-E dhe me ç'rast inicohet plani i veprimit (road map) për nënshkrimin e marrëveshjes së kyçjes KOSTT-ENTSO-E. Paraprakisht, ENTSO/E krijon grupin e ekspertëve të cilët fillimisht dërgojnë pyetësorin për vlerësim vetanak të aftësive operuese të KOSTT-it konform politikave nga doracaku për operim të ENTSO/E. Vlerësimi vetanak i ashtuquajtur CMA (compliance monitoring assesment) është plotësuar nga grupi punues në KOSTT dhe është dërguar te grupi i krijuar nga ENTSO-E për vlerësim në muajin dhjetor 2014. Në fund të Janarit grupi vlerësues i themeluar nga ENTSO-E konstaton se CMA është plotësuar me sukses dhe mund të procedohet më tutje propozimi në Asamblenë e radhës të ENSTO-E. Me këtë rast, arrihet pajtueshmëria që fillimisht KOSTT të operoj si Blllok rregullues/zonë rregulluese. Me rekomandimet e Grupit të Ekspertëve, deri në fund të majit 2015 KOSTT-i obligohet që plotësisht të kryej testimet e proceseve:

- Skedulimi (Scheduling)
- Barazimi (Accounting)
- DACF – modeli i rrjetit

Tri proceset e lartpërmendura të përcaktuara nga ENTSO/E, paraqesin kushtin e vetëm që KOSTT të nënshkruaj marrëveshjen e kyçjes me ENTSO/E, ndërsa proceset e pa plotësuara të prezantuara në pyetësorin e vetëvlerësimit do të kenë një afat kohor prej dy vitesh që të implementohen nga ana e KOSTT-it. Një ndër obligimet kryesore mbesin implementimi i projektit LFC, integrimi i zonës observuese të rrjetave fqinje dhe anasjelltas në sistemin SCADA/EMS, etj.

Pas angazhimeve të pakursyera të stafit teknik të KOSTT-it, dy proceset e para janë kryer me sukses dhe janë vlerësuar si teste të cilat kanë marrë dritën e gjelbër nga grupi i eksperteve të ENTSO/E, ndërsa procesi i tretë i cili ka të bëjë me përgatitjen e modelit kompjuterik të rrjetit të KOSTT-it për të realizuar parashikimin një ditë para të fyteve të ngushta të rrjetit (Day ahead contingency forecast), para realizimit të suksesshëm të tij, në mënyrë arbitrare dhe me qëllime plotësisht politike bllokohet nga EMS tri ditë para nënshkrimit të marrëveshjes së kyçjes me ENTSO/E, e cila ishte paraparë të ndodhte me 8 maj

në Asamblenë e mbajtur të ENTSO/E në Bruksel. Ky bllokim i qëllimshëm nga ana e EMS në kundërshtim me obligimet e marra nga marrëveshja për energjinë në mes të dy shteteve, ndikoi në shtyrjen e vendimit për nënshkrim të marrëveshjes së kyçjes me ENTSO/E deri në mbledhjen e radhës së Asamblesë e cila pritet të mbahet gjatë muajit qershor 2015. Aktivitetet në përmbushje të rekomandimeve nga pyetësi vetëvlerësues i ENTSO/E do të

vazhdojnë me përkushtim nga stafi i KOSTT-it. Me prioritet të lartë e cila ndërlihet me synimin e KOSTT që sa më shpejtë të bëhet anëtarë i ENTSO/E është implementimi i projekti i LFC me Shqipërinë, si dhe implementimi i zonës së observimit të OST-ve fqinje në SCADA/EMS. Këto dy projekte janë duke u zhvilluar me sukses dhe pritet që të përfundojnë bazuar në dinamikën e planifikuar.

Ministrja për Dialog znj.Edita Tahiri vizitoi KOSTT-in

Gjatë vizitës që Ministrja për Dialog në Qeverinë e Kosovës znj.Edita Tahiri, e realizoi në KOSTT në shkurt të këtij viti u njoftua me rrjedhat e implementimit të Marrëveshjes së Operimit që ka dalur nga Marrëveshja për Energji e firmosur në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë. z. Naim Bejtullahu, Kryeshef Ekzekutiv i KOSTT gjithashtu njoftoi Ministren Tahiri për të arriturat si në aspektin e investimeve në ngritjen e kapaciteteve të infrastrukturës si dhe operimin e Sistemit të Transmisionit, ashtu edhe për punën në drejtim të avansimit të funksioneve të operimit të tregut të energjisë elektrike të Kosovës.

Ministrja Tahiri u shpreh e kënaqur me punën që po bëhet në KOSTT dhe me këtë rast vlerësoi në veçanti kontributin profesional dhe ate institucional që e ka dhënë KOSTT në procesin e dialogut me Serbinë. Gjithashtu edhe për aktivitetet që KOSTT është duke i ndërmarrë në sigurimin e operimit si zonë rregulluese e pavarur në kuadër të asociacionit të operatorëve të transmisionit panevropian- ENTSO-E.

Më tutje Ministrja Tahiri foli për sukseset që janë arritur në dialogun me Serbinë përmes së cilit janë njohur kufijtë elektrik që njëkohësisht paraqesin edhe kufijtë shtetëror të Kosovës. Znj.Tahiri theksoi “Në KOSTT kam gjetë

bashkëpunim konstruktiv dhe mirëkuptim dhe me kontributin e shkëlqyeshëm të ekspertëve të kompanisë, së bashku kemi arritur që të ndërtojmë subjektivitetin ndërkombëtar të KOSTT. Tani përpara kemi një fazë shumë të rëndësishme që është faza e implementimit”.

Në shtator të vitit 2014, Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës (KOSTT) dhe Operatori i Sistemit të Transmisionit të Serbisë (EMS) patën nënshkruar Marrëveshjen për Operim (inter-TSO Agreement) e cila rregullon marrëdhëniet bilaterale që kanë të bëjnë me menaxhimin e rrjetit dhe operimin e Sistemeve të Transmisionit në mes të dy vendeve.

Marrëveshja për Operim u negociua nën patronatin e Sekretariatit të Energjisë për Evropën Juglindore me bazë në Vjenë dhe është përkrahur nga Komisioni Evropian.

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Operimit në mes të KOSTT dhe EMS janë shfuqizuar marrëveshjet e mëhershme: Marrëveshja e Përkohshme e Shkëmbimit të Energjisë dhe Marrëveshja e Përkohshme Teknike dhe gjithashtu aktivizohen Kodet EIC për zonën e KOSTT që mundësojnë shkëmbimin e informacioneve në mes të palëve në tregun e energjisë.



Sabri Musiqi, Kadri Kadriu, Elona Cecelia, Edita Tahiri, Naim Bejtullahu, Zana Bajrami Rama dhe Xhavit Sadiku

Ministrat Stavileci dhe Gjikhuri vlerësojnë progresin e punimeve në linjën interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri



Më 10 Mars 2015, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Naim Bejtullahu priti në vizitë në Nënstacionin 400/220 kV Kosova B, Ministrin për Zhvillim Ekonomik të Kosovës z.Blerand Stavileci dhe Ministrin e Energjetikës dhe Industrisë së Republikës së Shqipërisë z.Damjan Gjikhuri.

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT, z.Bejtullahu njoftoi ministrat me progresin e projektit të linjës interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri, i cili po implementohet sipas planit dhe dinamikës së paraparë. Ministrat u njoftuan që deri më tani është realizuar 35 % e projektit nga ana e Kosovës. Janë ndërtuar 93 bazamente të shtyllave të tensionit të lartë, janë montuar 60 shtylla si dhe janë instaluar afër 12 km përçues. Gjithashtu edhe çështjet rreth shpronësimeve janë në fazën përfundimtare të përmbylljes së procesit të servitutit në segmentin 3.

Janë ndërtuar 93 bazamente të shtyllave të tensionit të lartë, janë montuar 60 shtylla si dhe janë instaluar afër 12 km përçues

Me këtë rast Ministri i Zhvillimit Ekonomik të Kosovës z.Stavileci u shpreh shumë i kënaqur me ecurinë e punimeve dhe theksoi “Ishit dëshmitarë se pothuajse 1/3 e projektit është përfunduar, shpresojmë që deri në fund të vitit të përfundojë pjesa e Kosovës dhe në tremujorin e dytë të vitit të ardhshëm të përfundojë pjesa e Shqipërisë”.

Ndërsa Ministri i Energjetikës dhe Industrisë së Shqipërisë z.Gjikhuri theksoi “Bërja dhe përfundimi i kësaj linje krijon atë damarin e nevojshëm dhe shtyllën kurrizore ku Sistemi do të ngritet dhe do të harmonizohet me politika të përbashkëta, strategji të përbashkëta dhe investime të përbashkëta”.

BERZH akordon kredinë e parë për KOSTT me qëllim të zhvillimit të Sistemit Transmetues të energjisë elektrike të Republikës së Kosovës

Përfaqësues të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës (KOSTT), kanë nënshkruar marrëveshjen e parë për kredi financiare përmes së cilës do të bëhet financimi i disa projekteve për zhvillimin e Sistemit Transmetues të energjisë elektrike të Republikës së Kosovës. Marrëveshja u nënshkrua nga ana e z.Holger Muent, drejtor për Ballkanin Perëndimor i BERZH dhe z.Naim Bejtullahu, Kryeshef Ekzekutiv i KOSTT.

Marrëveshja parasheh sigurimin e kredisë komerciale afatgjate nga BERZH me kushte kredituese të buta në vlerë prej € 30 milion, me periudhë kthyesë prej 12 vite + 3 vite grejs periudhë. Ky investim do të mundësojë ndërtimin e disa nënstacioneve elektrike 110/10(20)kV në Kosovë, me qëllim të përmirësimit të cilësisë dhe besueshmërisë së furnizimit me energji elektrike nga aspekti i transmisionit. Gjithashtu, ndërtimi i këtyre nënstacioneve do të krijojë kushte të volitshme për zhvillim ekonomik në regjionet përkatëse.

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Naim Bejtullahu, duke falënderuar BERZH-in, me këtë rast theksoi “KOSTT në mënyrë të vazhdueshme përcjell trendet e kërkesës për energji elektrike të cilat padyshim janë në rritje. Ne, përmes Planit Zhvillimor të Transmisionit (PZhT) i planifikojmë projektet për zhvillimin dhe modernizimin e vazhdueshëm të Sistemit Transmetues të Republikës së Kosovës, me qëllim të përgatitjes së tij për të akomoduar ngarkesën. Pjesë e PZhT janë edhe këto projekte që do të financohen nga BERZH. KOSTT do të punojë me përkushtim të madhë në implementimin e këtij projekti shumë të rëndësishëm dhe besoj fuqishëm në bashkëpunimin e mëtutjeshëm dhe partneritetin me BERZH.”

Në anën tjetër z.Holger Muent, Drejtor i BERZH për Ballkanin Perëndimor shtoi: “Ne kemi kënaqësinë që të investojmë në këtë projekt të rëndësishëm për zhvillimin e transmisionit, i cili njëherit përbën investimin e parë të madh të Bankës në sektorin e energjisë në Kosovë. Ky projekt do të sjellë përfitime si për vendin ashtu edhe për rajonin në kuptimin e përmirësimit të sigurisë së energjisë elektrike. Ky është hapi i parë drejt ndërtimit të partneritetit të qëndrueshëm në mes të BERZH dhe KOSTT.”



Procesi i Shkëmbimit Ndërkufitar i të Dhënave Komerciale (Skedulimit) të KOSTT pas Nënshkrimit të Marrëveshjes për Kyçje me ENTSO-E

Për funksionimin normal të sistemit energjetik të përmasave të mëdha është e domosdoshme që të gjitha programet komerciale të tregtimit në kuadër të Zonës Sinkrone të Europës Kontinentale të harmonizohen paraprakisht. Harmonizimi bëhet një ditë para (D-1) ditës D (dita e kohës reale).

Deri në fund të vitit 2015 pritet që KOSTT të fillojë të operojë si zonë dhe bllok i pavarur rregullues në kuadër të Zonës Sinkrone të Europës Kontinentale. Operimi i KOSTT si operator i pavarur kërkon edhe përgaditjet adekuate teknike të KOSTT për menaxhimin kualitativ të shkëmbimit të të dhënave me operatorët fqinj si dhe me Qendrën Koordinative Jug të Europës Kontinentale.

Operimi i pavarur i KOSTT-it pritet të jetësohet me nënshkrimin e Marrëveshjes për Kyçje ndërmjet KOSTT dhe ENTSO-E (European Network Transmission System Operators for Electricity – Rrjeti Europian i Operatorëve të Sistemit Transmetues për energji elektrike).

Gadishmëria e KOSTT për menaxhim të pavarur të procesit të skedulimit në kuadër të Zonës Sinkrone

KOSTT aktualisht e shfrytëzon platformën softwerike të zhvilluar nga Siemens për procesin aktual të shkëmbimit të të dhënave për skedulim. Platforma aktuale është duke u rifreskuar (“update”-uar) dhe pritet që të plotësojë të gjitha kërkesat që dalin nga Marrëveshja për Kyçje ndërmjet KOSTT dhe ENTSO-E.

Platforma e IT-së për menaxhim të procesit të skedulimit ndër të tjera përfshinë edhe këto module të tjera:

Modulin e alokimit të kapaciteteve ndërkuftare, Modulin e procesit të llogaritjes ndërkuftare të matjeve interkonektive, modulin e llogaritjes së jobalanceve të palëve tregtare etj.

Modulet e implementuara i plotësojnë kërkesat dhe reko-mandimet që dalin nga ENTSO-E dhe standardet përkatëse të kësaj organizate për shkëmbim të informatave.


Në shkurt 2015 nga Takimi plenar i Grupit Regjional të Europës Kontinentale është përcaktuar plani akcional me afatet për të gjitha aktivitetet që

KOSTT duhet të ndërmerret në mënyrë që të starton operimin e pavarur më 1 qershor 2015. Si aktivitet i rëndësishëm (ndër të tjera) nga ky takim është paraparë edhe procesi i testimit të procesit të skedulimit. Në testim të procesit të skedulimit kanë marrë pjesë TSO-të fqinje të KOSTT (EMS (Serbi), CGES (Mali i Zi), MEPSO (Maqedoni), OST (Shqipëri)) si dhe TSO e Zvicrës në cilësinë e koordinatorit të Qendrës Koordinuese Jug (SWISSGRID). Testimi i procesit ka pasur rezultat pozitiv mirëpo nga operatori serb EMS janë paraqitur pengesa dhe procesi është bllokuar për arsye politike.


Pas nënshkrimit të Marrëveshjes për Kyçje me ENTSO-E procesi i skedulimit do të përfshijë të gjitha TSO-të fqinje të Kosovës (OST, CGES, MEPSO dhe EMS) si dhe SWISSGRID-in si Koordinator i Qendrës Koordinative Jug. Kemi tri kategori të shkëmbimit të të dhënave për skedulim: skedulimi ndërmjet zonave rregulluese, skedulimi ndërmjet blloqeve rregulluese si dhe dërgimi i raportit të skedulimit në Qendrën Koordinative Jug në Zvicër. Diagrami i thjeshtuar i shkëmbimit të të dhënave është paraqitur më poshtë:



Sherif Dedaqi



Pozicioni i ri që pritet ta ketë KOSTT si zonë dhe bllok i pavarur rregullues në Zonën Sinkrone është paraqitur në diagramin e mëposhtëm:




Autor: Sherif Dedaqi

KOSTT përkrah Baletin Kombëtar të Kosovës

Në përpjekje të vazhdueshme për të qenë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit, KOSTT ka zhvilluar edhe një iniciativë tjetër, besojmë unike, për të kontribuar në zhvillimin e një segmenti paksa më të veçantë të artit skenik i cili nga oborret aristokrate shekuj më parë tashmë ka evoluar në degë profesionale të artit të vallëzimit. Me përkrahjen që KOSTT e ka realizuar për Baletin Kombëtar të Kosovës ndër të tjera është mundësuar edhe realizimi i Premierës së parë të Baletit Kombëtar të Kosovës për vitin 2015, me shfaqjen e bazuar në veprën e Shekspirit, “Othello”.

Ansambli i parë i Baletit të Kosovës i formuar në vitin 1972 ka funksionuar deri në vitin 1991 vit kur dhunshëm balerinët kosovarë u larguan nga Teatri Kombëtar, si rezultat i situatës politike që mbretëronte në atë kohë në Kosovë. Pas rikthimit i cili ndodhi pas luftës në Kosovë, gjenerata e parë e balerinëve kosovarë diplomon në vitin 2005. Ndonëse mjaft e re, Trupa e Baletit të Kosovës ka arritur nivel të lartë të profesionalizmit, me balerinë të përkushtuar

ndaj punës dhe për momentin është njëra ndër trupat më të reja në Ballkan, por që renditet krahas Trupave evropiane për nga cilësia.



Vendimet e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë Janar– Qershor 2015

Gjatë periudhës Janar-Qershor 2015, Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë ka marrë disa vendime në lidhje me kërkesat që janë parashtruar nga KOSTT në këtë institucion:



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

- Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 10 prill 2015, në bazë të kërkesës së KOSTT, ka marrë vendim për aprovimin e dokumenteve për prokurimin e shërbimeve ndihmëse: Kushtet e Përgjithshme për shërbimet ndihmëse, Shpjegime për kontratë të shërbimeve ndihmëse dhe udhëzimet tenderuese, Kriteret për vlerësimin e ofertave për shërbimet ndihmëse, Ftesë për tender për ofrimin e shërbimeve ndihmëse për vitin [yyyy] (V_731_2015)
- Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur 10 prill 2015, në bazë të kërkesës së KOSTT, ka marrë vendim t'i lejohej KOSTT-it derrogimi në zbatimin e dispozitave të Rregullave të Tregut. (V_730_2015)
- Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur 10 prill, në bazë të kërkesës së KOSTT, ka marrë vendim të aprovohet dokumenti “Procedura për Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive dhe Nominimet e Kapaciteteve Ndër-Kufitare“ (V_728_2015)
- Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 03 prill 2015, në bazë të kërkesës së KOSTT, ka marrë vendim për aprovimin e tarifave dhe ngarkesave që do të zbatohen nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) sh.a. (V_721_2015)
- Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 03 prill 2015, në bazë të kërkesës së KOSTT, ka marrë vendim për aprovimin e të Hyrave Maximale të Lejuara (MAR) që do të mbulohen nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) sh.a, përmes tarifave dhe ngarkesave për vitin relevant tarifar SHTE9. (V_717_2015)
- Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 20 shkurt 2015, në bazë të kërkesës të KQKO, ka marrë vendim të aprovohet amandamentimi i dokumentit “Kodi i Matjes” të KOSTT sh.a. (V_713_2015)
- Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 20 shkurt 2015, në bazë të kërkesës të KQKO, ka marrë vendim të aprovohet amandamentimi i dispozitave të Standardeve Elektrike të KOSTT sh.a. (V_712_2015)
- Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 20 shkurt 2015, në bazë të kërkesës të KQKO, ka marrë vendim të aprovohet amandamentimi i dokumentit “Kodi Operativ” të KOSTT sh.a. (V_711_2015)
- Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 20 shkurt 2015, në bazë të kërkesës të KQKO, ka marrë vendim të aprovohet amandamentimi i dokumentit “Kodi i Balancit” të KOSTT sh.a. (V_710_2015)
- Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 20 shkurt 2015, në bazë të kërkesës të KOSTT, ka marrë vendim të aprovohet amandamentimi i dispozitave të Kodit për Stacionet Gjeneruese të Energjisë me Erë të KOSTT sh.a. (V_709_2015)
- Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 20 shkurt 2015, në bazë të kërkesës të KOSTT, ka marrë vendim të aprovohen Procedurat e Rregullave të Tregut. (V_708_2015)

